



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË KORÇË

VENDIM

Nr. 87, datë 29.08.2025

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË BASHKISË KORÇË
NR. 185, DATË 28.12.2022, "PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E
SHËRBIMIT TAKSI NË BASHKINË KORÇË"

Këshilli i Bashkisë Korçë pasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë të Kontrollit të Territorit dhe Drejtorisë të Përgjithshme të Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit dhe Menaxhimit të Kontratave "Për një shtesë në vendimin e Këshillit të Bashkisë Korçë nr. 185, datë 28.12.2022, 'Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit taksi në Bashkinë Korçë', bazuar në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998, "Për transportet rrugore", i ndryshuar, neni 35; ligjin nr. 139/2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar, neni 54, pika k; ligjin nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës të Shqipërisë";

VENDOSI :

1. Në pikën 3 të vendimit të Këshillit të Bashkisë Korçë nr. 185, datë 28.12.2022, "Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit taksi në Bashkinë Korçë", shtohet nënpike: XIII. Në rrugën "Kiço Greço", pranë hyrjes kryesore të Pazarit të vjetër të qytetit, vetëm për automjete elektrike taksi (3 vende parkimi, sipas plan-vendosjes nr. 13).
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Kontrollit të Territorit, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike dhe Policia Bashkiake.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Eva Naçi

Miratur me 23 vota

Vota Pro 23

Vota Kundër 1

Vota Abstenim 1

Zbardhur më datë 29-08-2025

KRYETARI I KËSHILLIT TË BASHKISË

Ana Verushi



P-V NR. 13

